

VENDIM
Nr.531, datë 30.7.2004

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2004, PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË BURGJEVE
TË PEQINIT DHE TË RROGOZHINËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7, 8 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në numrin e miratuar të punonjësve për vitin 2004, t’i shtohen 88 veta.

2. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 47 642 000 (dyzet e shtatë milionë gjashtëqind e dyzet e dy mijë) lekësh, për rritjen e kapaciteteve të burgjeve të Peqinit dhe të Rrogozhinës, i ndarë si më poshtë vijon:

- Paga 24 040 000 lekë;
- Sigurime shoqërore 7 395 000 lekë;
- Shpenzime operative 16 207 000 lekë;

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano